



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

SISTEMET E DREJTËSISË NË DISA NGA SHTETET E BALLKANIT PERËNDIMOR, REFORMA NË DREJTËSI

Rialda Xhizdari *, Klevent Xhizdari**

**Albanian University*

*** Business Center "Gkam"*

Përmbledhje

Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë një sistem drejtësie i cili përballlet me sfida të mëdha. Dalja e tyre si një sistem i centralizuar ka rezultuar në një ndikim të drejtëpërdrejtë lidhur me funksionimin efektiv dhe të besueshëm. Në shumicën e tyre këto sisteme janë të prekura nga mungesa e pavarësisë së institucioneve gjyqësore që lidhet me ngadalësimin e proceseve ligjore për shkak të praktikës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Kjo mungesë e pavarësisë së institucioneve ka shkaktuar dhe shkaktonte probleme lidhur me ndikimin politik dhe korruptiv të proceseve gjyqësore si dhe zgjatjen në kohë të tyre, duke rrezikuar integritetin dhe besueshmërinë e drejtësisë në këto vende. Reforma në drejtësi tek shtetet e Ballkanit Perëndimor paraqitet si një angazhim i fortë që synon forcimin e pavarësisë së institucioneve gjyqësore, përmirësimin e kapaciteteve dhe aftësive të personelit gjyqësor si dhe thjeshtimin e procedurave ligjore me qëllim rritjen e efikasitetit të drejtësisë. Parë në këtë këndvështrim, bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe mbështjetja për këto reforma janë thelbësore për përparimin e drejtësisë në Rajon dhe për ndërtimin e shoqërive të drejta dhe të barabarta.

Punimi është një analizë e sistemit të drejtësisë së këtyre vendeve, institucioneve, reformave të zbatuara drejt apo jo, problematikave duke synuar të ofrojë një kuptim të qartë të situatës aktuale dhe të propozojë hapat e nevojshëm drejt një sistemi gjyqësor më të fortë dhe më efektiv.

Fjalë çelës: *Sistem Drejtësie, Ballkan Perëndimor, Reformë në Drejtësi, Proces gjyqësor*

JUSTICE SYSTEMS IN SOME OF THE BALKAN STATES WESTERN. REFORM IN JUSTICE

Abstract

The states of the Western Balkans have a justice system which faces great challenges. Their emergence as a centralized system has resulted in a direct impact on effective and reliable operation. In most cases, these systems are affected by the lack of independence of judicial institutions, which is

related to the slowing down of legal processes due to the practice of Judges and Prosecutors. This lack of independence of institutions has caused and continues to cause problems related to the political and corruptive influence of judicial processes as well as their prolongation, endangering the integrity and reliability of justice in these countries. Justice reform in the Western Balkan states is presented as a strong commitment aimed at strengthening the independence of judicial institutions, improving the capacities and skills of judicial personnel, as well as simplifying legal procedures in order to increase the efficiency of justice. Seen from this point of view, international cooperation and support for these reforms are essential for the advancement of justice in the Region and for the construction of fair and equal societies.

The work is an analysis of the justice system of these countries, institutions, reforms implemented correctly or not, problems aiming to provide a clear understanding of the current situation and propose the necessary steps towards a stronger and more effective judicial system.

Keywords: *Justice System, Western Balkans, Justice Reform, Judicial Process.*

Hyrje

Një sistem drejtësie ndërtohet në bazë të disa elementeve kyçe dhe përbëhet nga një strukturë komplekse e institucioneve dhe proceseve që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë në një vend ose një rajon të caktuar. Struktura e këtij sistemi është e njëjtë për të gjithë shtetet, duke përfshirë:

1. **Kushtetuta dhe Ligjet:** Kushtetuta e një vendi përcakton strukturën dhe funksionet e sistemit të drejtësisë, bazën legjislative për funksionimin e drejtësisë duke caktuar organizimin e gjykatave, pushtetet e tyre, dhe rolin e institucioneve të tjera të drejtësisë. Ky dokument përcakton strukturën dhe funksionimin e institucioneve të drejtësisë, të drejtat dhe liritë e qytetarëve, rregullat që duhet të ndiqen në procesin gjyqësor. Ligjet e tjera përcaktojnë detajet e procedurave ligjore, të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme në procesin gjyqësor.
2. **Institucionet Gjyqësore:** Këto përfshijnë gjykatat në të gjitha nivelet e tyre, organet e tjera gjyqësore, si prokuroria dhe organet e zbatimit të ligjit. Gjykatat janë përgjegjëse për të dëgjuar dhe vendosur në lidhje me çështjet ligjore, ndërsa prokuroria ka detyrën për të ndjekur dhe përfaqësuar interesat e shtetit në gjykatë. Këto përfshijnë gjykatat në të gjitha nivelet e tyre, nga gjykatat themelore deri te gjykatat e larta, si dhe organet tjera gjyqësore si gjykatat administrative, gjykatat për krime të veçanta, dhe gjykatat kushtetuese. Institucionet gjyqësore janë përgjegjëse për dënimin ose lirimin e individëve, duke u bazuar në provat dhe argumentet paraqitura në gjyq.
3. **Personeli Gjyqësor:** Ky përfshin gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe personelin tjetër që punon në sistemin gjyqësor. Në një sistem të drejtësisë të ndërtuar mirë, personeli gjyqësor duhet të jetë i përgatitur, i pavarur dhe i përkushtuar për zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e drejtës së palëve në gjyq. Prokuroria është e përgjegjshme për ndjekjen e rasteve penale dhe përfaqësimin e interesave të shtetit në gjyq, ndërsa avokatura është përfaqësuesi ligjor i palëve në një proces gjyqësor. Këto institucione janë thelbësore për sigurimin e një procesi të drejtë dhe të barabartë para ligjit.
4. **Procedurat Gjyqësore:** Përfshijnë rregullat dhe procedurat që ndiqen gjatë një procesi gjyqësor, duke përfshirë dorëzimin e dokumenteve, dëshmitarët, argumentet e palëve, dhe përfundimin e vendimeve gjyqësore.

5. **Mekanizmat e Apelit dhe Kontrollit:** Një sistem i fortë drejtësie përfshin mekanizma për rishqyrtimin e vendimeve gjyqësore në raste të përsëritura ose në raste kur ka dyshime për drejtësinë e vendimit. Këto mund të jenë Gjykatat e Apelit, Gjykatat e Larta, Gjykatat Kushtetuese, ose mekanizma të tjera të caktuara për këtë qëllim.
6. **Financimi dhe Resurset:** Sistemi i drejtësisë duhet të ketë resurse të mjaftueshme për të funksionuar në mënyrë efektive. Kjo përfshin buxhetin e nevojshëm për operacionet e përditshme, trajnimin e personelit, modernizimin e teknologjisë, infrastrukturës, dhe shërbimeve për palët që përfshihen në procesin gjyqësor.

Demokracitë liberale udhëhiqen nga Parime të cilat janë të zbatueshme nga të gjithë shtetet dhe qytetarët Evropianë mbi të cilat është themeluar BE-ja. Një prej këtyre Parimeve është edhe “Sundimi i Ligjit”. Ky Parim është i lidhur me zbatimin në mënyrë të barabartë të ligjit nga të gjithë anëtarët e shoqërisë pavarësisht nga statusi që ato mund të kenë, (privatë, shtetërore, kompani, biznese apo organe qeveritare).

Ky Parim i sundimit të ligjit duke mos patur një përkufizim zyrtar përfshin gjashtë Parimet të cilat janë themelore për gjithë sistemin e drejtësisë në shtetet anëtare të BE. Këto parime janë:

1. *Procedura legislative transparente dhe demokratike.*
2. *Siguria juridike.*
3. *Ndarja e pushteteve.*
4. *Rishikimi efektiv i gjyqësorit.*
5. *Gjykatat e pavarura dhe të paanshme.*
6. *Barazia para ligjit.*

Në këtë kuadër, para shteteve të Ballkanit Perëndimor të cilat aderojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, shtrihet një sfidë kryesore “*vendosja e fortë e sundimit të ligjit sipas standarteve Evropiane*”. Për të arritur anëtarësimin këtyre shteteve ju nevojiten reforma të harmonizuara me politika dhe infrastruktura të standartizuara me ato të kërkuara nga standartet e zgjerimit të BE-së.

Në Shqipëri, Reforma në Drejtësi, është trajtuar si një instrument i cili të jep mundësinë që përveç miratimit të thjeshtë të *acquis communautaire* dhe qasjes së ndërtimit të kapaciteteve. Mësimet e nxjerra nga zbatimi i kësaj Reforme në Shqipëri ka ndihmuar në zbatimin dhe monitorimin më të mirë të reformave institucionale në gjithë Ballkanin Perëndimor. Gjatë kohës që po përparonin reformat në Shqipëri, ndryshoi metodologjia e zgjerimit të Bashkimit Evropian duke lejuar rritjen e rolit të vendeve anëtare në procesin e anëtarësimit. Kjo konsiston në mënyrën se si Komisioni Evropian dhe Shtetet anëtare sillen ndaj zbatimit të metodologjisë bazuar në kapituj (Komisioni Evropian) dhe progresit të reformave duke përfshirë një shkallë më të lartë të kushtëzimit politik (shtetet anëtare), përpara hapjes zyrtare të negociatave të anëtarësimit. Përmendim rastin e Shqipërisë (1) dhe të Maqedonisë së Veriut (2).

Përveç kësaj, zhvendosja drejt bazave dhe rritja e rolit të vendeve anëtare të BE ka çuar në një proces më të gjatë dhe kompleks zgjerimi duke shkuar përtej miratimit të thjeshtë të *acquis communautaires* por duke lejuar edhe analizën e kompleksitetit të çështjeve që u shfaqën gjatë zbatimit të ligjit së bashku me mekanizmat e mirëqeverisjes së strukturave të reja. Rasti i Shqipërisë shërben si një përvojë unike ku zgjerimi është ndërthurur me reformat institucionale të vendit dhe ku vendet anëtare të BE-së kanë marrë një rol udhëheqës në shqyrtimin e tyre.

Bashkimi Evropian, në mënyrë të përsëritur raportonte për progresin e Shqipërisë në rrugën e reformave që i nënshtrohen anëtarësimit në BE. Paralelisht, nga Parlamenti Evropian u ngrit një Komitet Parlamentar për Reformën në Drejtësi (3) i përbërë nga ekspertë të nivelit të lartë. Anëtarët e këtij Komitetit Ad-Hoc ishin nga BE, SHBA, ekspertë të tjerë Ndërkombëtarë dhe vendas. Dokumenti

analitik që u përgatit nga ky Komitet, shërbeu si një bazë për zhvillimin e një strategjie dhe plan veprimi për Reformën Drejtësi (4). Ky dokument kishte si qëllim kryesor të evidentonte një system ekzistues të korruptuar, joefikas, jo funksional të drejtësisë, si dhe të forconte institucionet ekzistuese dhe nëse do të ishte e nevojshme të krijoheshin institucione të reja. (5)

Reforma në Drejtësi do të kishte si objektiv ngritjen e një sistemi të plotë të verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, krijimin e institucioneve të reja që drejtojnë gjyqësorin, krijimin e një Prokurorie dhe Gjykata të Posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe reformimin thelbësor të institucioneve ekzistuese, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Prokurorinë e Përgjithshme. Reformat institucionale u penguan edhe si rezultat i një kolapsi në të cilën hyri gjyqësori për shkak të mos funksionimit të Gjykatës së Lartë dhe asaj Kushtetuese për arsye se kontrolli filloi më parë nga këto gjykata dhe kjo e gjeti të papërgatitur sistemin gjyqësor në tërësi.

Reforma në drejtësi në Shqipëri është miratuar në korrik 2016, reforma në drejtësi njihet kryesisht për procesin e vetingut dhe kohën e gjatë që u desh për vënien në funksion të institucioneve të reja të drejtësisë. Por përvoja shqiptare është shumë më e gjerë.

Shumë ndryshe paraqitet *situata në Kosovë*. Si një shtet i ri, Kosova, ka ndjekur një model rindërtimi në vendosjen e stabilitetit dhe sundimin e ligjit të lidhura ngushtë me procesin e shtet ndërtimit imponuar dhe Paketa e Ahtisarit ka qenë kyçe dhe është kombinuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton pavarësinë e sistemit gjyqësor duke garantuar emërimin e përhershëm deri në moshën e pensionit dhe paga të mira, Reforma ligjore ka përfshirë aspekte të ndryshme, si krijimi i mekanizmave jashtë gjykatës duke ndihmuar në efikasitetin e gjyqësorit. Në frymën e një reforme thelbësore, janë hartuar Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale. Sfidat më të mëdha gjatë procesit të riemërimit dhe emërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka qenë rekrutimi i stafit profesional në sistem.

Reforma në Drejtësi, në Kosovë, nuk ka patur një strategji gjithëpërfshirëse që do të drejtonte aktivitetin e Institucioneve duke lehtësuar vlerësimin e arritjeve të Reformës. Përballja me shumë sfida (6) e kanë vënë gjyqësorin në një gjendje të reformave të vazhdueshme (7). UNMIK-u dhe Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) ishin të angazhuara në hartimin e politikave, ligjeve dhe në krijimin e mekanizmave dhe institucionet që do të ndihmonin sistemin. Reformat kanë të bëjnë me transferimin e kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët duke i hapur rrugën hartimit të legjislacionit të ri si dhe kalimit të kompetencave të caktuara nga Ndërkombëtarët tek vendorët. Edhe pas fitimit të pavarësisë disa pushtete me elementë shtetndërtues mbetën në duart e institucioneve ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe UNMIK-un, si rasti i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale, Interpoli etj. Në këtë proces, palët e ndryshme të interesuara kanë arritur një konsensus për shumë iniciativa që duhej të ndërmerreshin.

Për shkak të brishtësisë së sistemit, “nuk ka pasur asnjë kontribut të gjyqësorit por kontribut të gjyqtarëve në baza individuale në aspektin e hartimit të legjislacionit për gjykatat dhe KGJK-në”. Qeveria e Kosovës gjithmonë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë rregullimit të përgjegjësisë të këtij misioni dhe gjithmonë ka kërkuar që të konsultohet ngushtë me Bashkimin Evropian për ndryshime të mundshme. Një vëmendje e vazhdueshme iu kushtua rishtruktimit të gjykatave dhe prokurorive, me qëllim qartësimin e përgjegjësisë, avancimin e profesionalizmit të stafit, thjeshtimin e sistemit dhe lehtësimin e aksesit të publikut. Në këtë këndvështrim, krijimi i Gjykatave Themelore, të Apelit dhe të Lartë u konsiderua si opsioni më i pranueshëm nga të gjitha palët e interesuara.

Në mungesë të një vizioni gjithëpërfshirës, kontributi i ekspertëve vendas, komunitetit ndërkombëtar, misionëve të tyre dhe organizatave të ndryshme donatore pati një ndikim të rëndësishëm në formësimin e kësaj reforme, duke imponuar praktika të vendeve të tjera. Sistemi i drejtësisë së Kosovës është më së shumti i ndikuar nga sistemi juridik amerikan, si dhe ndërthur elemente të shkollës juri-

dike gjermane dhe franceze. Nëse shikojmë Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, zbulojmë një sistem të përzier drejtësie që kombinon praktika dhe institute nga sistemet gjermane, franceze, italiane dhe anglo-saksone.

Gjatë procesit të reformës, ndikimi politik ka qenë prezent, konkretisht gjatë procesit të riemërimit dhe emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procesit të filtrimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në poste drejtuese. Mangësia tjetër e procesit të reformës së stafit në procesin e emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ishin kriteret e përcaktuara për këtë proces. Përvoja e punës e përcaktuar në kriteret për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte e pakuptueshme profesionistët. Administrata është një pjesë thelbësore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, sepse bën një punë të madhe në përgatitjen e çështjeve. Në të njëjtën kohë, ishte mjaft shqetësues fakti se kjo administratë ishte trashëguar nga sistemi i kaluar dhe kishte kontribuar shumë në mangësitë gjyqësore të pasluftës. Prandaj, procesi i reformës së personelit, i cili përfshinte gjyqtarët dhe prokurorët, përmes procesit të riemërimeve dhe emërimeve duhej të krijojnte një mekanizëm dhe një proces që do të merrej edhe me stafin mbështetës dhe punonjësit administrativë. Për më tepër, nëse procesi i reformës nuk do e parashikonte këtë, do të konsiderohej një dështim i madh. Përgatitja e një strategjie gjithëpërfshirëse – nevoja për të zhvilluar një strategji se si duhet të vazhdojë reforma, në mënyrë që të vendosen synimet dhe të fillohet të ndërmerren iniciativa. Një strategji e tillë do të ndihmonte në vlerësimin e ligjeve dhe politikave të tjera.

Maqedonia e Veriut do të duhet të përqafojë dhe zbatojë plotësisht reformat në fushat themelore të sundimit të ligjit, në veçanti reformën gjyqësore dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat themelore, forcimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike, si dhe kriteret ekonomike. Kjo nga ana tjetër do të nxisë rritje të qëndrueshme dhe të përsëhjetuar ekonomike dhe konvergjencë sociale, Institucione demokratike funksionale që sigurojnë që pushteti të rrjedh nga populli përmes një sistemi përfaqësues me zgjedhje të lira dhe të ndershme në thelb. Reforma e administratës publike, përfshin menaxhimin e financave publike, për të garantuar që ajo të jetë efikase, profesionale, e paanshme dhe e përgjegjshme për t'u shërbyer interesave të qytetarëve dhe biznesit. Vlerat themeluese të BE-së përfshijnë sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Një sistem gjyqësor efektiv (i pavarur, cilësor dhe efikas) dhe një luftë efektive kundër korrupsionit janë të një rëndësie të madhe, siç është respektimi i të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë.

Maqedonia e Veriut miratoi një Strategji për reformën në drejtësi për periudhën 2017-2022 dhe një plan veprimi shoqërues (8). Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Reformën në Drejtësi është miratuar në seancën e Këshillit për monitorimin e Reformës në Drejtësi të mbajtur në prill të vitit 2023. Është në përgatitje e sipër një strategji e re gjithëpërfshirëse për reformën në drejtësi për periudhën 2023-2027. Janë krijuar strategji nën-sektorale për menaxhimin e burimeve njerëzore në gjykata dhe në Prokurorinë Publike. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë po përcaktojnë përkatësisht numrin e pozitave për Gjykatë dhe Prokurori Publike. Gjyqësori është i organizuar si një sistem gjyqësor me tre shkallë, Gjykata Themelore, Gjykata të Apelit, Gjykata e Lartë, një Gjykatë Administrative dhe një Gjykatë të Lartë Administrative.

Sistemi gjyqësor i Maqedonisë së Veriut iu nënshtrua reformave të vazhdueshme që përmirësonin pavarësinë, efikasitetin dhe profesionalizmin e saj të përgjithshëm. Zbatimi i strategjive të njëpasnjëshme të reformës gjyqësore i lejoi Maqedonisë së Veriut të adresonte rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecias dhe Grupi i Ekspertëve të Lartë për çështjet sistematike të sundimit të ligjit. Organet e pavarura drejtuese, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë, vazhduan zbatimin e planeve strategjike të reformës, duke i ndihmuar ata të vendosin një balancë ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies. E rëndësishme ishte të sigurohej që gjyqësori të jetë i mbrojtur efektivisht nga çdo rrezik apo perceptim i ndërhyrjes së padrejtë.

Maqedonia e Veriut gjatë këtyre viteve ka patur detyrim të përfundojë zbatimin e strategjisë së reformës në drejtësi dhe planit të përditësuar të veprimit. Një fokus i veçantë u vendos në miratimin e një ligji të ri për procedurën civile dhe në përgatitjen e strategjisë së re për reformën në drejtësi, në përputhje me standardet evropiane. Maqedonia e Veriut po përshpejton zbatimin e strategjive të burimeve njerëzore për gjyqësorin dhe prokurorinë publike. Sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore janë plotësisht funksionale.

Këshilli Gjyqësor është organi vetëqeverisës që ka për detyrë të sigurojë dhe garantojë pavarësinë e gjyqtarëve. Ai përbëhet nga gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre, anëtarët e zgjedhur janë pjesëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Maqedoninë e Veriut, me qëllim të ruhet përfaqësimi i duhur dhe i drejtë i qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve dhe anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, me shumicë absolute të numrit të përgjithshëm. deputetë dhe shumica absolute e numrit të përgjithshëm të deputetëve që u takojnë komuniteteve joshumicë, anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Ministri i Drejtësisë janë anëtarë ex officio. Megjithatë, ata nuk kanë të drejtë vote dhe as nuk marrin pjesë në seancat për emërime dhe shkarkime. Këshilli Gjyqësor ka kompetencë ekskluzive për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Përveç kësaj, Këshilli Gjyqësor është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve. Ai vendos për përgjegjësinë disiplinore të anëtarëve të tij, të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave dhe mund të vendosë për përfundimin ose shkarkimin e funksionit të gjyqtarit.

Raportet zyrtare tregojnë progres përse i përket dinamikës së zgjidhjes së çështjeve të pazgjidhura si dhe veprime të vazhdueshme lidhur me zbatimin e Sistemit Informativ Gjyqësor në **Republikën e Malit të Zi**. Progres ka patur në lidhje me transparencën e Gjykatave dhe Këshillit Gjyqësor. Pikëpamjet dhe opinionet e përgjithshme juridike të Gjykatës Supreme të Malit të Zi gjenden në faqen e internetit të Gjykatës, si dhe një pjesë e vendimeve të gjykatave të zakonshme dhe të Gjykatës Kushtetue. Hartimi i legjislacionit të ri ka ndikuar në riorganizimin e rrjetit gjyqësor duke dhënë një pasqyrë më të qartë të numrit aktual të Gjyqtarëve, Prokurorëve Publikë, Oficerëve dhe punonjësve të Gjyqësorit. Ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal të Malit të Zi, janë shoqëruar me disa marrëveshje dypalëshe për ndihmë juridike në çështjet civile dhe penale dhe për zbatimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale me Maqedoninë, Kosovën dhe Bosnjën.

Republika e Malit të Zi ka kryer një sërë reformash, të cilat dëshmojnë vullnetin politik por edhe dinamizmin e padyshimtë në fushën legjislative. Përparimet janë bërë në një sërë fushash, veçanërisht në hartimin e Kushtetutës së re. Nënshkrimi i deklaratës që pranon shtatë parimet minimale që do të përfshihen në Kushtetutën e Malit të Zi është një shembull konkret i përkushtimit të autoriteteve malazeze ndaj vlerave të Këshillit të Evropës dhe ka qenë një hap i madh përpara në procedurën e anëtarësimit të vendit në Këshillin e Evropës.

“Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të BE-së dhe si i tillë, një element thelbësor i procesit të pranimit në BE, i cili përcakton ritmin e përgjithshëm të negociatave të pranimit të Malit të Zi në BE. E rëndësishme për Malin e Zi është mos kthimi mbrapsht i arritjeve të tij në fushën e gjyqësorit duke demonstruar përkushtimin e tij për zbatimin e plotë dhe të qartë të reformës dhe që të arrihet konsensus politik në Parlament për emërimet në gjyqësor.

Mali i Zi mbetet mesatarisht i përgatitur kur bëhet fjalë për sistemin e tij gjyqësor duke mbetur i bllokuar zbatimi i reformave kyçe në drejtësi. Janë bërë disa emërime gjyqësore të nivelit të lartë të pritur prej kohësh, ndërsa disa të tjera, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese (për të cilën kërkohet një shumicë e cilësuar në Parlament) janë ende në pritje por mbetet shqetësim për performancën institucionale dhe konsolidimin e Këshillave të pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Rekordi i përgjegjshmërisë gjyqësore mbetet i kufizuar. Pavarësia, integriteti, përgjegjshmëria dhe profesionalizmi efektiv i gjyqësorit duhet të forcohen më tej, duke përfshirë zbatimin e kuadrit përkatës kushtetues dhe ligjor dhe duke miratuar ndryshime legjislative në përputhje me standardet evropiane. Efikasiteti

i gjyqësorit gjithashtu duhet të forcohet. Miratimi i një strategjie të re për racionalizimin e rrjetit gjyqësor është ende në pritje, si dhe zbatimi i strategjisë së TIK për gjyqësorin. Mali i Zi vazhdon të bëjë përparim në trajtimin e brendshëm të krimeve të luftës.

Dispozitat e reja kushtetuese synonin të reduktonin ndikimin politik në gjyqësor duke transferuar emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe çështje të tjera të lidhura në juridiksionin e Këshillit Gjyqësor. Përveç kësaj, njësitë themelore organizative në gjyqësor janë zhvilluar më tej.

Themelimi, organizimi dhe juridiksioni i gjykatave, organizimi i punës së gjykatave dhe administrata gjyqësore rregullohen me Ligjin për gjykatat (9). Ligji parashikon parimet përkatëse të ligjshmërisë, të drejtës për qasje në drejtësi, barazisë, publicitetit, gjykimit të paanshëm brenda një kohë të arsyeshme. Në Mal të Zi ekzistojnë gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e specializuara. Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm janë: Gjykatat për kundërvajtje, Gjykatat themelore, Gjykatat e larta, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Gjykatat e specializuara janë: Gjykata Ekonomike dhe Gjykata Administrative. Ekzistojnë tri gjykata për kundërvajtje për të gjithë territorin e Malit të Zi (në Bijelo Polje, Budva dhe Podgoricë), mbi ankesat ndaj vendimeve të gjykatave të përmendura për kundërvajtje vendos Gjykata e Lartë për Kundërvajtje.

Në Mal të Zi ka këshilla të veçantë për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve (Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial). Organi i specializuar që merret me menaxhimin e personelit në gjyqësor është prezantuar me Ligjin për gjykatat e vitit 1991, përbërja dhe kompetencat e këshillit kanë ndryshuar vazhdimisht.

Këshilli është organ i pavarur dhe autonom i cili siguron pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve dhe gjykatave. Kjo reflektohet në faktin se Këshilli nuk ka të drejtë vetëm të propozojë kandidatë për gjyqtarë sipas legjislacionit të mëparshëm, por është plotësisht përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve. Në këtë mënyrë, procedura e emërimeve në drejtësi zhvendoset nga Kuvendi dhe i besohet Këshillit. Selia e Këshillit është në Podgoricë (10).

Sistemi gjyqësor i Malit të Zi ka pësuar një transformim thelbësor në vitet e kaluara, me rregullime të ndryshme ligjore dhe institucionale të bëra për të lehtësuar reformat në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, pas vitesh përpjekjesh, “Mali i Zi mbetet mesatarisht i përgatitur për të zbatuar *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore” (11), siç theksohet në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2023 për Malin e Zi. Gjyqësori po përballë me një kërkesë urgjente për të përmirësuar efikasitetin dhe për të siguruar funksionim profesional dhe të përgjegjshëm. Gjatë vitit 2023, dështimi për të zgjedhur anëtarin e shtatë të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorin e Lartë të Shtetit dhe anëtarët e rinj të këshillit gjyqësor, ka vënë në rrezik planet për reformën gjyqësore në Mal të Zi.

Konkluzione dhe Rekomandime

Reforma në drejtësi në Shqipëri ka demonstruar kompleksitetin e shoqërimit të progresit të një vendi drejt përmbushjes së kushtëzimit të BE-së, ndërkohë që po kalon në një proces të kushtueshëm dhe të gjatë reformash të thella dhe të shfaqjes së rezultateve dhe rezultateve të prekshme të shpejta. Megjithatë, pavarësisht nga anët negative dhe papërsosmëritë e saj, shtrirja dhe thellësia e reformës së sektorit të drejtësisë në Shqipëri përfaqëson një rast studimi për të kuptuar, vlerësuar dhe përshtatur rëndësinë sistematike të proceseve reformuese të drejtësuara nga anëtarësimi në BE në Ballkanin Perëndimor. Me ndryshimin e më shumë se një të tretës së Kushtetutës së saj, Shqipëria mund të konsiderohet si kryesuesja e reformave në krahasim me vendet e tjera candidate për në BE në rajon. Parë nga ky këndvështrim, përvoja e reformës së sektorit të drejtësisë në Shqipëri dhe mësimet e nxjerra gjatë hartimit dhe zbatimit të reformës në drejtësi mund të zbatohen në sektorë të tjerë si dhe në vendet e tjera të Ballkanit.

Kosova duhet të përgatisë një strategji gjithëpërfshirëse që do të ndihmojë në vlerësimin e ligjeve dhe politikave si dhe në koordinimin e aktiviteteve ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet të analizojnë dhe gjejnë një model të avancuar dhe model më efikas për të përmirësuar llogaridhënien e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Përsa i përket Reformës Administrative të zhvillohet një metodë filtrimi i stafit mbështetës dhe stafit administrativ duke krijuar mekanizma efikase për performancën e tyre.

Maqedonia e Veriut ka një nivel të përgatitjes mesatare lidhur me funksionimin e gjyqësorit. Korniza legjislative dhe institucionale për gjyqësorin në Maqedoninë e Veriut ka një nivel të mirë të harmonizimit me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane, megjithatë, Maqedonia e Veriut duhet të forcojë në mënyrë efektive, pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të konsolidojë llogari dhënien dhe integritetin. në të gjitha nivelet e gjyqësorit, dhe të rrisë aksesin dhe cilësinë e drejtësisë, të ofruar në mënyrë efikase.

Mali i Zi mbetet mesatarisht i përgatitur për të zbatuar *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, por ka bërë përparim të kufizuar në përgjithësi. Nuk është arritur asnjë përparim në reformën në drejtësi, fusha më sfiduese e sundimit të ligjit deri më sot. Sistemi gjyqësor vazhdon të përballet me një krizë të thellë institucionale, duke rezultuar në lidhshmëri dhe menaxhim të dobët, mungesë vizioni strategjik dhe planifikim të dobët, duke ndikuar në aftësinë e vendit për të dhënë drejtësi. Mali i Zi vazhdon të përmbushë detyrimet e tij për të drejtat themelore sipas instrumenteve dhe legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe gjyqtarët dhe Ligji për Prokurorinë e Shtetit mbeten për t'u ndryshuar në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane.

LITERATURA

1. European Commission (2014), "Albania Progress Report". <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014D0096>
2. EU Council, Council conclusions on enlargement and stabilization and association process – Albania and the Republic of Northern Macedonia. <https://ec.europa.eu/en/press/press-releases/2020/03/25/councilconclusions-on-enlargement-and-stabilisation-and-association-process/>
3. Established with the Decision 96/2014, 27.11.2014. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014D0096&from=EN>
4. The Strategy on the Justice Reform and Action Plan. <http://www.reformanedrejttesi.al/dokumenti-strategjik-dheplani-i-veprimit>
5. <https://cdinstitute.eu/wp-content/uploads/2020/09/EU-Enlargement-in-Balkans-and-Justice-Reform-in-Albania-1.pdf>
6. Prishtina: Organization for Security and Cooperation in Europe, Mission in Kosovo, January 2012), pg. 6.
7. Judicial Independence in Kosovo: Institutional and Functional Dimensions (Prishtinë: Organization for Security and Cooperation in Europe, Mission in Kosovo, January 2012), pg. 6.
8. https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zakoni/lae_on_courts.pdf
9. Official Gazette of Montenegro No. 11/15.
10. The EC report objectively presented the situation in the judiciary (<https://mina.nees/vijesti-iz-crnogore/izvjestaj-ek-objektivno-predstavio-stanje-u-pravosudu/>).
11. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/montenegro-report-2023_en